

Dr. Emin Pllana

## **RAPORTI I VITIT 1858 I KONSULLIT AUSTRIAK NË SHKODËR, PËR PASHALLËKUN E PRIZRENIT**

Në Arkivin Shtetëror të Austrisë në Vienë<sup>1</sup> ndodhet një raport origjinal i Konsullit të Austrisë, Majorit, në Shkodër, i cili në 39 faqe e lajmëronte qeverinë e Vienës për gjendjen ekonomike shoqërore dhe politike në Pashallëkun e Prizrenit.<sup>2</sup> Raporti që është mjaft i gjerë, paraqet njëfarë analize të situatës politike, shoqërore dhe ekonomike të Pashallëkut të Prizrenit për disa vjet (1851—1858). Konsulli austriak mendonte në atë kohë të udhëtonte prej Shkodre për të vizituar, si thotë vetë, Pejën, Gjakovën, Prizrenin dhe disa qytete të tjera të kësaj ane. Pasha i Prizrenit e lajmëronte konsullin se situata në këto vende ishte e çrregulluar me turbullira dhe se udhëtimi i tij ishte i pamundshëm. Ai porositte konsullin që vizitën ta shtyente për më vonë. Mirëpo, konsulli ishte i vendosur, udhëtoi në Pashallëkun e Prizrenit, por e ndërroi drejtimin e udhëtimit nëpër Kosovë. Më parë vizitoi Prishtinën, Kaçanikun, Shkupin, Tetovën dhe në fund Prizrenin. Në bazë të këtij raporti shihet se në vitet 1856 dhe 1857 në Krafshin e Dukagjinit popullsinë shqiptare e kishte përfshirë një pakënaqësi e madhe, e ndoshta një kryengritje kundër pushtetit osman. Konsulli nuk ka dhënë shënime se çfarë përpjestimi ka pasur ajo lëvizje e popullsisë shqiptare. Si duket, Porta e Lartë gjatë viteve 1856 dhe 1857 ndërmori disa ekspedita ushtarake kundër rezistencës shqiptare, sidomos në Krahinën e Kosovës, e cila kishte marrë përpjesëtime të mëdha. Administrata osmane me ekspedita

<sup>1</sup> Originali i këtij dokumenti është në Haus Hof und Staatsarchiv, Wien, Konsulatte XVIII, Scutari 1853—1912 oktobre 1958, Borowiczka, Major, Konsul.

<sup>2</sup> Disa konsuj austriakë, francezë dhe të vendeve të tjera në këtë kohë Sanxhakun e Prizrenit e quajnë Pashallëk i Prizrenit. Kështu e quan konsulli Major në raportin për të cilin është fjala; Emile Wiet konsulli i Francës në Shkodër në veprën *Memoire sor le pachlik de Prizrend*, Buletin de la societe de geographie, oct. Paris 1866; H. Hecquard, *Historie et description de la Haute Albanie ou Guegarie Paris* e të tjerë. Mirëpo, siç dihet, pashallëqet marrin fund me rënien e Pashallëkut të Shkodrës në vitin 1831. Atëherë Perandoria Osmane e bëri riorganizimin e ri administrativ. Prizreni, sipas burimeve, deri në vitin 1868 është qendër e Sanxhakut, ndërsa në periudhën 1868—1877 qendër e Vilajetit.

ushtarake pati për qëllim t'i detyronte shqiptarët për të dhënë tati me dhe rekrut për ushtri.

Në raport konsulli jep disa shënime me vlerë për njohjen e rrethanave ekonomike, shoqërore dhe politike në territorin e Sanxhakut të Prizrenit, e sidomos për territorin e Kosovës. Duhet theksuar se në raport kemi edhe disa të dhëna joobjektive e tendencioze, që me siguri konsulli i paraqet ashtu si i përgjigjej politikës së jashtme të Austrisë. Prandaj, analiza objektive e këtij raporti është me rëndësi për të kaluarën historike të kësaj treve.

Perandoria austriake në këtë kohë luajti rol të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo pati ndikim të madh edhe tregoi interesim të madh për territoret e Gadishullit Ballkanik. Austria, duke filluar prej gjysmës së dytë të shekullit XIX, filloi të kthehej nga Gadishulli Ballkanik, hartoi plane pushtuese për territoret që e shpënin në drejtim të Selanikut dhe më tej në Lindjen e Afërt. Territori i Sanxhakut të Prizrenit, i banuar me shqiptarë, serbë, maqedonë, romë, turq, vllah e të tjerë, ishte i inkuadruar në aspiratat dhe planet pushtuese të Perandorisë austriake. Për t'i realizuar këto qëllime, diplomacia austriake qe shumë aktive, organizoi një rrjet të gjerë përfaqësish diplomatike në Ballkan. Kështu, përfaqësitë, si në Prizren, Shkodër, Manastir dhe vende të tjera zhvilluan një propagandë të fortë në interesin e qeverisë së vet.

Raporti i konsullit austriak është i ndarë në gjashtë tërësi: 1) Vendi dhe popullsia, pozita gjeografike dhe politike, 2) bujqësia, blegtoaria, industria, tregtia dhe mjetet e komunikacionit, 3) rrethanat kulturore, arsimore dhe udhëheqësit fetarë, 4) politika e organizimit administrativ të pashallëkut — gjendja administrative, funksionarët osmanë, 5) përfaqësitë e jashtme në Pashallëkun e Prizrenit, nevoja për vendosjen e agjentëve austriakë.

Autori në fillim të kaptinës së parë të raportit shpjegon qëllimin e tij. Ai thotë se në vitin 1851 Ministria Mbretërore e Tregtisë së Austrisë ndërmori organizimin e institucioneve konsullare dhe se në planin zyrtar të këtij aksioni ishte përfshirë edhe Pashallëku i Prizrenit. Konsulli austriak thekson se nga mungesa e të dhënave zyrtare ishte i detyruar ta shkruante raportin në bazë të asaj që përjetoi gjatë udhëtimit të tij në këto vende.

Në bazë të raportit shihet se Perandoria Austriake kishte filluar të tregonte interesim të madh për disa territore të Ballkanit e posaçërisht për vendet e banuara edhe me shqiptarë. Duhet theksuar se Majori në këtë raport jep shënime më së shumti për territorin e Sanxhakut të Prizrenit (ai e quan pashallëk). U nis prej Shkodre, kaloi Drinin, nga skela Mjed në drejtim të maleve të Pukës, kaloi Urën e vezirit dhe doli në territorin e Pashallëkut të Prizrenit. Ai më tej përshkruan fushat, lumenjtë dhe pyjet e Rrafshit të Dukagjinit. Prizrenin e quan qendër të rëndësishme politike dhe administrative. Konsulli mendonte ta vizitonte Pejën e Gjakovën, mirëpo pasha i Prizrenit e këshillonte të mos i vizitonte këto vende, sepse rrethanat ishin të ndërlikuara. Vetë konsulli pohon se Peja dhe Gjakova para një kohe të shkurtër ishin bërë vende të çrregullimeve ose të kryengritjeve, të cilat tregojnë

dobësinë e perandorisë në një gjendje të tmerrshme. Prandaj pasha, nga frika e ndonjë rreziku, kërkoi që konsulli austriak ta ndërronte planin e vizitës, gjë që edhe vetë konsulli pranoi propozimin e tij. Kjo tregon se në vitet 1851—1858 popullsinë shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit e kishte përfshirë një pakënaqësi aq e madhe, saqë në të gjitha anët kishin filluar lëvizjet kundër pushtetit osman.

Për këto arsye konsulli major e ndërroi drejtimin e udhëtimit dhe ai thotë: »Unë, pra, u drejtova për në Prishtinë dhe prej aty shkova në Kaçanik, Shkup e Tetovë (Kallkandelen) dhe u ktheva në Prizren«. Majori në vazhdim shkruan për fushën dhe luftën e Kosovës, për qytetin Prishtinë, malin Golesh, për Tyrben e Sulltan Muratit e të tjera. »Fusha e Kosovës është e njohur si e plleshme« — shkruante konsulli, mirëpo ai thekson se bujqësia ishte në gjendje të mjerueshme. Ai, siç duket, gjatë rrugës kishte vizituar fshatin Babush, të cilin e quan të mjerueshëm, pastaj Kaçanikun, përmend lumin Lepenc, kështjellën e Kaçanikut dhe rëndësinë strategjike të këtij vendi. Prej Kaçanikut ai vazhdon rrugën për në Shkup, i cili përmend fushën e plleshme të Shkupit dhe rëndësinë strategjike ushtarake të këtij qyteti, i cili gjendet në kryqëzimin e rrugëve.

Sipas konsullit austriak, Prizreni kishte 25 mijë banorë, prej tyre 20 mijë muslimanë (shqiptarë e turq) 4200 serbë dhe 800 katolikë. Prishtina kishte 8900 banorë, prej tyre 6400 muslimanë, shqiptarë e turq dhe 2500 serbë, ndërsa Shkupi kishte 13 mijë muslimanë, 7 mijë ortodoksë, serbë e maqedonë dhe 800 jahudi, gjithsej 20800 banorë, ndërsa Tetova, sipas tij, kishte 6 mijë muslimanë, 4500 ortodoksë, që do të thotë maqedonë dhe 616 katolikë, që gjithsejt, sipas tij, kishte 10.516 banorë. Në Pashallëkun e Prizrenit, sipas tij, në qytete elementi musliman ishte më i madh, ndërsa në fshatra dhe pjesët malore musliman ishte më i banorëve muslimanë dhe ortodoksë ishte gati i barabartë, ndërsa numri i katolikëve ishte mjaft i vogël. Sipas tij, territori i Pashallëkut të Prizrenit në pikëpamje fetare përfshihet në Kryepeshkopatën e Shkupit, që gjenden vetëm 6 famulli katolike, të cilat ishin në Prizren, Gjakovë, Pejë, Janjevë, Malin e Zi (Cërrna gora) të Shkupit dhe në Zym. Numri i banorëve të këtyre famullive ishte afër 6.500 veta. Sipas prejardhjes dhe kombësisë, shkruan Majori, popullsia i përket pjesërisht racës serbe e bullgare (fjalën bullgare e përdor për maqedonët) dhe pjesërisht asaj shqiptare. Popullsia, pos këtyre gjuhëve, flet edhe pak turqisht.

Në kaptinën e dytë të raportit përfshihet bujqësia, blegto-ria, industria dhe mjetet e komunikacionit. Sipas tij, bujqësia dhe blegto-ria ishin në shkallën më të ulët. »Kjo është si rezultat i prapambeturisë së popullsisë, e cila nuk i kushton kujdes zhvillimit të këtyre degëve ekonomike, si dhe e sistemit të kobshëm administrativ, i cili zhvillimin e ekonomisë kombëtare jo vetëm që nuk e përmirëson, por me syçelur e pengon«. Zhvillimi ekonomik, sipas konsullit, është i prapambetur pjesërisht nga mungesa e zhvillimit të tregtisë dhe të komunikacionit. »Fshatari, i cili shpeshherë ishte vetëm qiraxhi i parcelave të tokës, pro-

dhon, pra, vetëm aq sa ka nevojë për ta mbajtur familjen. Nga kjo rrjedh se në vitet e dobëta dhe të paplleshme ai lufton me uri. Ai tokën e lavron me vegla primitive, me përmendë të drurit që e ngrehin dy qej të dobët. Misri, gruri, elbi, thekra, hardhia, duhani dhe orizi afër Shkupit janë prodhimet kryesore të tokës. Njerëzit nuk dinë për mbajtjen e shtazëve, ata nuk dinë për plehërimin e tokës, shpeshherë e lënë tokën me vite të papunuar. Mbajnë numër të pamjaftueshëm shtazësh dhe të cilësisë së dobët. Vetëm mbajtja e dheneve u shkon përdore pa ndihmën e të tjerëve, prej të cilave merret leshi i cilësisë së mirë, i cili shitet edhe në tregun e Evropës. Të mbajturit e kuajve është i lënë krejtësisht pasdore. Ata i përdorin vetëm për të fshirë grurin në lamë«. Në Kosovë, shkruan Majori, mbahen kuaj të vegjël, të shkëlqyeshëm, të gjallë dhe mjaft të fortë. Në këtë vend të pasur me tokë dhe kullosa, ku bujqësia dhe blegtoia janë shumë të pazhvilluara, nuk mund të flitet për industri. Në qytete çdo gjë përkufizohet në përpunimin e leshit për veshje, për qilima, sexhade të thjeshta, të cilave prodhimet tona (të Austrisë) u bëjnë konkurrencë, si në pikëpamje të cilësisë ashtu edhe në pikëpamje të çmimeve. Mirëpo, në disa qytete, si në Prizren, Shkup, Gjakovë e të tjera, përpunohet lëkura dhe rripi i shkëlqyeshëm, prodhohen armë të ndryshme, përpunohen dhe montohen grykat e pushkëve që importohen nga Italia, Austria dhe vendet e tjera të Evropës. Në disa qytete prodhohen vegla të bujqësisë, si qerret e të tjera, mirëpo rrotat e tyre nuk mbështillen me hekur, sepse hekuri është tepër i shtrenjtë. Mungesa e qerreve e vështirëson transportimin e prodhimeve, rrugët janë tejet të këqia. Në fshatra shtëpitë ndërtohen me baltë dhe mbuloohen me kashtë të thekrës, ndërsa në qytete bëhen me çerpiq, njëkatëshe të ulëta, që u ngajnë kasollave. Shtëpitë në fshatra janë në gjendje të mjerueshme.

Majori për këtë gjendje të vështirë të popullsisë e fajëson pushtetin osman. Mirëpo, konsulli habitet me pastërtinë brenda në shtëpitë që i vizitoi dhe thotë: »Prandaj isha jo pak i befasuar që brendia e tyre e pastër e pajisur me një konfor siç mund të dëshironte njeriu«.

Konsulli në raport shkruan edhe për hanet ose bujtinat përgjat rrugës prej Shkodre deri në Prizren, që ishin afër 20, të ndërtuara prej gurit ose drurit e që u ngjanin kasollave. Në këto hane për ndriçim përdorej pisha, tregtarët dhe udhëtarët në hane flinin në shtalla bashkë me kuaj. »Gjatë verës për një udhëtar evropian më mirë ishte të flinte përjashtë nën qiell sesa në han. Sana dhe uji ishin lëndët e vetme që i gjente udhëtari në hane«. Konsulli thekson se Shkodra ishte qendër tregtare për të gjitha vilajetet e pashallëkut. Pastaj ai shkruan për Tivarin, Ulqinin, Lezhën e qytete të tjera. Ai Prizrenin e quan qytet qendror të tregtisë. Për distriktet që gjenden në veri dhe në verilindje të malit Sharr, kryeqytetet e të cilave janë Gjakova, Peja, Prishtina dhe Gjlani. Prizrenit si qendër tregtare i mungojnë mjaft burimet e jashtme dhe furnizimi me lëndë të ndryshme. Mirëpo, Prizreni tregtinë kryesore e zhvillon me Shkodrën, Shkupin dhe Selanikun. Sipas Majorit, Prizreni kishte një të metë, gjendej larg

skeleve detare, prandaj ishte i varur mjaft nga Shkodra, e cila ishte e lidhur me det me tregjet evropiane, Trieshtën, Venedikun, Selanikun e të tjera. Konsulli e sheh të nevojshme ndërtimin e një rruge, e cila do ta lidhte Prizrenin me Shkodrën. Ai Drinin e konsideron si të papërshtashëm për lundrim, i cili nuk lejon ndërtimin e një rruge pranë tij, sepse kalon për vende malore. Në lidhje me këtë rrugë, Majori thotë se nuk mbetet pra kurgja tjetër veç të kërkohet lidhja ndërmjet skelës Medua në afërsi të Shkodrës dhe Urës së Vezirit, që është vija më e shkurtër që duhet të kalojë nëpër brigjet e larta.

Majori thekson se është mungesë e madhe që nuk ekziston një urë mbi Dri, prandaj njerëzit lumin e kalojnë me drunj të gërryer, në formë të barkës, ose me drunj të lidhur në formë tërthore, ku qiten njerëzit dhe kuajt me mall. Një kalim i tillë i lumit është mjaft i rrezikshëm. Për të kaluar Drinin çdo njeri pagan një pjastër për veti e një për kali. »Duke marrë parasysh mungesën e çdo lidhjeje postale ndërmjet Shkodrës dhe Prizrenit, kuptohet fakti se tregtia mund të përkufizohet vetëm në artikujt më të nevojshëm«, — shkruan Majori. Bajtja e mallrave kushtonte shumë shtrenjtë. Një barrë kali prej një qyteti në qytetin tjetër në peshë se në 200 kilogramë kushtonte 110 deri 120 pjastra, ose 9 deri 10 dukatë (gulden). Në Prizren importohen mallrat koloniale si parfeme, bylyzyk, paste, unaza, pej, shpagë, gryka të pushkëve, krip, tekstil dhe artikuj të tjerë luksozë evropianë. Nga Prizreni eksportohet lesh, lëkura, sexhade të trasha, rripa, armë të gatshme si dhe mish e drithra. Eksportimi i këtij qyteti ishte i orientuar në Shkodër, Trieshtë, Venedikë, Dubrovnik e gjithë vendet tjera.

Majori në raport flet edhe për sigurimin e tregtisë dhe të komunikacionit nga ana e pushtetit osman. Kështu ai thotë se pushteti nuk është në gjendje të sigurojë një polici për sigurimin personal. Megjithatë, në këto rrugë të tregtisë ndodhën më pak plaçkitje se në rrugët e tjera tregtare të Perandorisë Osmane. Fiset malësore të këtij territori nëpër troje të cilave kalon rruga prej Drinit te Skelja e Mjedës dhe Ura e Vezirit nuk janë grabitçare, sepse tek ato ekzistojnë institucione të forta patriarkale që sigurojnë ruajtjen e personave dhe të pronës. Sipas atyre zakoneve patriarkale silltet udhëtari dhe udhëheqësi i karavanit nën mbrojtjen e mikut e të zotit të shtëpisë, në rajonin e të cilit ai ka hyrë. Tregtarët dhe udhëtarët e plaçkitur i mbron gjithë fisi. »Rast plaçkitje të një udhëtari prej një hanxhie deri tani nuk ka ndodhur«, shkruan Majori. Ai thekson se zakonet fisnore janë më të forta se pushteti osman. Majori në raportin e vet shkruan edhe për hakmarrjen ndërmjet fiseve shqiptare. Sa i përket mjeteteve të komunikacionit ndërmjet Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Prishtinës e Gjilanit, rrugët janë të rëndomta, të këqia, u ngjajnë rrugëve të fshatit dhe mund të kalohet me qerre me katër rrotë. Në juglindje të malit Sharr, në territoret e Pashallëkut, Shkupi luan rol të madh po si Prizreni dhe Tetova, importon prodhime të ndryshme industriale, më së shumti nga Shkodra, nëpër rrugën e Sharrit dhe të Kaçanikut. Kështu, disa tregtarë si agjentë

të shtëpive tregtare të vendeve të ndryshme kryejnë punët afari-  
ste. Edhe Shkupi furnizohet me gjëra të nevojshme prej deposë  
së Shkodrës. Mirëpo, Shkupi si qendër tregtare fillon të furnizo-  
het me prodhime të ndryshme nga Selaniku, sepse rruga është  
më e mirë.

Shkupi eksporton prodhime bujqësore si lesh, lëkura, mish,  
drithra, rripa e të tjera. Duhanin e eksporton në Selanik dhe në  
Sarajevë. Në këtë kohë Shkupin nuk varet më si Shkodra prej  
tregtisë austriake. Shkupi është kthyer krejtësisht nga Selaniku,  
gjë që i bën dëm tregtisë së Austrisë. Majori në fund të kësaj  
kaptinë angazhohet për zhvillimin dhe përparimin e lidhjeve eko-  
nomike, tregtare dhe politike me këtë pjesë të Perandorisë Os-  
mane, e cila do të jetë dikur një treg i dobishëm për prodhimin  
e industrisë së Perandorisë Austriake. Ai e bën me dije qeverinë  
e vet me situatën politike e sidomos me mentalitetin e njerëzve,  
si dhe me ngjarjet politike.

Në kaptinën »Rrethanat kulturore, pronarët e mëdhenj fe-  
tarë dhe arsimit«, autori pohon se gjysma e popullsisë së Pashallë-  
kut të Prizrenit predikon islamizmin, ndërsa pjesa e dytë, me  
përjashtim të një numri të vogël, diku 6500 katolike, i takon ki-  
shës ortodokse uniate. Sipas Majorit, myslimanët që mbajnë reli-  
gjionin shtetëror zënë vendin e parë në krahasim me përfaqësue-  
sit e besimeve të tjera. Në qytete gjenden një numër i mjaftue-  
shëm faltoresh, xhamish dhe kishash dhe mbahen mirë. Autori i  
raportit thotë se shtëpitë e jetesës të klerit myslimanë janë të  
mira. »Për një fanatizëm religjioz mysliman nuk kam mundur  
të zbuloj kurfarë shenjash«. Po ashtu, nuk mund të flitet për  
lutjet e vërteta religjioze të popullsisë. Masa e gjerë, e cila e ka  
pranuar islamizmin, pjesërisht me presion ose për interesa, është  
në kontakt të përhershëm dhe mban lidhje me popullsinë e krishterë.  
Në anën tjetër, fanatizmi religjioz i ortodoksëve uniatë është  
më i fortë, që do të thotë se traditat dhe puna e kishës ortodokse  
ishin më të fortë dhe është më e organizuar. »Mendoj — thotë  
konsulli — se ortodoksët janë topër besimtarë, pa marrë para-  
sysh se nuk i dinë gjërat fetare«. Nga kjo shihet se kisha orto-  
dokse kishte ndikim të madh te popullsia. Në anën tjetër, thek-  
son majori, pushteti osman është larg më i përshtatshëm në  
koncesione, më liberale nga të gjitha sundimet jomuhamedane në  
lidhje me religjionin. Konsulli shkruan sesi populli me të holla  
të veta ndërton kisha dhe xhami. Një familje në Shkup për ndër-  
timin e kishës ka dhënë afër 1500 dukatë. Ai thekson se popullsia  
e Prizrenit bëhet gati për ndërtimin e një kisha, mirëpo pasi nuk  
ka mjaft të holla, ndihma do të kërkohet jashtë Turqisë. Majori  
thekson se priftërinjtë ortodoksë jetojnë shumë keq, vishen me  
rroba që i bëjnë vetë me punë dore. Ai thekson se në Prizren  
punonte peshkopi Meletiq, i cili është mjaft ireligjioz.

Sa i përket katolikëve të Pashallëkut të Prizrenit, ata para-  
qesin element jo të rëndësishëm. Mirëpo, ndonjëse përbëjnë një  
minoritet, duket se janë mjaft kompakt. Mirëpo, si duket, janë  
mjaft të ndarë dhe nuk paraqesin problem politik për pushtetin  
osman. Si latinë, atë në organet e shtetit nuk janë të dashur dhe

më pak çmohcn. Katolikët e Pashallëkut të Prizrenit gjenden në veri dhe veriperëndim të Sharrit, që ndahen në pesë parohi, që janë: e Prizrenit, e Gjakovës, e Pejës, e Janjevës dhe e Karadakut (Mali i Zi i Shkupit), të cilët formojnë peshkopatën e Shkupit me seli në Prizren. Kishat katolike janë të varfëra dhe të ndërtuara dobët. Në lidhje me qëllimin e komunës katolike që në çdo qytet të ndërtohet nga një kishë e re, lajmëroi se në Janjevë ka filluar ndërtimi i një kishë të re për të cilën peshkopi i Dioqezës nga paraardhësi i tij ka marrë rezervë në të holla më se një mijë guldenë nga madhëria e tij perandori. Ai kërkoi ndihmë nga mbretëresha e Spanjës dhe qeveria perandorake e Francës, mirëpo, nuk mori asgjë. Nga madhëria e tij, perandorit Ferdinand dhe perandoreshës Anemari, mori 500 guldenë. Prej madhërisë së vojvodës Ferdinand Maksimilianit dhe Sharlotës mori 300 guldenë. Zoti peshkop, si duket, ka ndihmë nga bashkësia e Lionit afro 300 franka në vjet, që janë mjaft për ndërtim. Siç shihet, qeveria e Austrisë qysh atëherë i kushtoi kujdes të madh popullsisë të besimit katolikë, dha ndihmë të madhe materiale për ndërtimin e kishave. Në këtë mënyrë ajo zhvilloi një propagandë të madhe për përfitimin e popullsisë katolike, për realizimin e interesave dhe qëllimeve pushtuese në këto anë.

Në lidhje me gjendjen kulturo-arsimore konsulli thekson se për këtë mund të flitet vetëm në qytete të pashallëkut. Ekzistojnë disa shkolla myslimane private, ku mësohet shkrim-leximi dhe kurani. Serbët kanë në Prizren dhe në Prishtinë nga një shkollë dhe në Shkup tri shkolla. Mësuesit janë nënsh tetas të Serbisë ose të Austrisë (mendohet nga Vojvodina ose Bosnja e Kroacia), të cilët paguhen me rrogë vjetore 2500 deri 4000 pjastra. Mësimet zhvillohen në bazë të teksteve shkollore të Serbisë, të shkruara në bazë sistemit shkollor austriak. Rinia në fshatra është e prapambetur dhe e pashkolluar. Katolikët në Prizren kanë një shkollë fillore, të cilës, me lutjen e peshkopit dhe me propozimin e konsullatës nga lartmadhëria e tij perandori, në bazë të vendimit prej 21 maj 1856, iu dha ndihmë 400 guldena në vjet. Si arsimtar në këtë shkollë është punësuar K.K. Matteo Stanich me rrogë vjetore 360 guldenë, ndërsa 40 guldena peshkopi do t'i përdorë për adaptimin e dhomave mësimore, për blerjen e rekuizitave shkollore. Në vitin shkollor 1857—1858 shkolla kishte 60 nxënës.

Në kaptinën e katërt, *Organizimi politik-administrativ i pashallëkut gjendja në administratë dhe funksionarët osmanë*, autori shkruan për rregullimin dhe ndarjen administrative, si dhe për funksionarët shtetërorë. Siç shihet, Sanxhaku e Prizrenit ai e quan pashallëq, mirëpo në tekst e quan Sanxhaku i Prizrenit ose i Shkupit. Sipas tij, territori i Sanxhakit të Prizrenit apo të Shkupit ndahet në këto pashallëqe, ndoshta kaza (rrethe): Gjakova, Peja, Prishtina me qarqet e Janjevës, Vuçiternës e të Mitrovicës, Vranja me qarkun e Gjilanit, Shkupi me qarkun e Kumanovës, Tetovës, Shkupit, Pallankës, Koçanit dhe Kaçanikut; Tetova me qarqet e Gostivarit e të Kiçevës dhe kaza e Prizrenit. Majori thekson se këtë organizim administrativ Porta e Lartë e bëri pas shkatërrimit të pashallëqeve të mëdha, si dhe pas reformave të

Tanzimatit. Ai thekson se Porta e Lartë themeloi Pashallëkun e Shkupit me seli në Prizren. Pashallëkun e Shkupit, (fjala është për Sanxhakun e Shkupit apo të Prizrenit) ai e ndan në këto qarqe ose mydyrllëqe (rrethe). Prizrenin e konsideron si njësi të veçantë administrative nën drejtimin e qeverisë së Sanxhakut. Në këtë kontekst Shkupin e merr si qendër të kajmekamllëkut, pastaj vijnë me radhë mydyrllëqet — Tetova, Kumanova, Kratova, Pallanka, Koçani, Vranja, Gjilani, Prishtina, Vuçiterna, Peja dhe Gjakova. Sipas tij, mydyrllëqet Pallanka, Kumanova dhe Kratova janë në kuadrin e kajmekamllëkut të Shkupit, ndërsa të tjerat janë të lidhura drejtpërdrejt me qendrën udhëheqëse, selinë provinciale me guvernierin si e quan ai, në Prizren. Konsulli në raport shkruan sesi ishte gjendja e rregullimit administrativ para Reformave të Tanzimatit në kohën e «pashajve trashëgues», të cilët sundonin të pavarur sipas interesave të tyre egoiste. Ai thekson se ata mblidhnin tatimet e ndryshme në mënyrë despotike dhe i harxhonin për vete. Ata kurgjë nuk bënin për zhvillimin ekonomik, për ndërtime, për shkolla dhe për arsimin e popullsisë. Konsulli shkruan për dobësitë e pushtetit osman, për mospërfilljen e ligjeve, mospësigurimin e njerëzve për anarshinë, korrupcionin dhe plaçkitjen e funksionarëve shtetërorë, për harxhimet e mëdha dhe jetën luksoze të tyre. Ai shkruan për pozitën e vështirë të masave të gjera që ishin të ngarkuara me tatime të mëdha, për luftërat e shpeshta ndërmjet feudalëve, të cilët dëmtonin popullsinë, digjeshin shtëpitë, vriteshin dhe plaçkiteshin njerëzit e të tjera. Konsulli në raport përmend Abdurrahman dhe Hivzi Pashën dhe sarajet e tyre në Tetovë, Shkup dhe në Prizren, për jetën luksoze dhe haremin e tyre. Konsulli konstaton se pas dhënies së Reformave të Tanzimatit dhe vendosjes së pushtetit të drejtpërdrejtë të Portës së Lartë janë bërë disa ndryshime të vogla. Sipas tij, reformat nuk u zbatuan, çarmatimi i popullsisë nuk u bë i plotë, malësorët e pashallëkut mbeten të paprokur. Edhe në rrafshina dhe në qytete popullsia myslimane mban armë. Në zbatimin e ligjit dhe sigurimin publik nuk u bë asgjë. Edhe më tej ekzistojnë kryengritës dhe banda shkatërruese nga zaptitë, të cilët përbënin policinë provinciale turke. Ata paguheshin dobët, vetëm 80 deri 90 pjastra rrogë mujore, prandaj bashkëpunonin me banda dhe plaçkitnin popullsinë. Asnjë mydyrr udhëheqës i kazës ose rrethit nuk e di gjendjen e vërtetë në vendin ku sundon. Çdokush vepron sipas dëshirës së vet. »Para ardhjes sime në pashallëk, — shkruan konsulli — u vra mydyrri i Vuçiternës nga banorët e vendit. Për masat që i mori pasha ndaj popullsisë nuk janë të njohura«. Në pranverën e ardhshme në Gjakovë dhe në Pejë situata është përzier. Popullsia është ngritur kundër pushtetit osman dhe mydyrrëve që i përzunë. Hakif Pasha arsyetohej se nuk dispononte ushtri të rregullt që të merrte masa kundër kryengritësve. Atëherë, sipas konsullit, Faik Mustafa Pasha me ushtri gjendej afër Prishtinës dhe përgatitej për të marrë masa kundër kryengritësve. Ai thotë se pasha, për ta shuar lëvizjen, si mydyr në Vuçiternë e mori një nga udhëheqësit e kryengritësve dhe kështu arriti ta qetësonte gjendjen.

Për pozitën e banorëve të besimeve të ndryshme që i nënshtroheshin ligjit nuk dihet mirë. Dëshmimi para gjyqit të krishterëve u lejohej në qoftë se procesi nuk bëhej kundër muslimanëve. Në proceset gjyqësore kundër myslimanëve dëshmonin më tepër romët. Pushteti nuk merrte kurrfarë masash për zhvillimin e shkollave, të industrisë, tregtisë dhe të agrokulturës. Për vendosjen e komunikacionit pushteti kishte paraparë zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës prej Kaçaniku deri në Shkup. Punëtorët e rrugëve paguheshin shumë pak, saqë me vete merrnin bukën e vet. Punëtorët paguheshin jo nga shteti, por nga populli, i cili paguante tatime për rrugë. Zbatimin e drejtësisë e ndamin funksionarët, kadijtë dhe udhëheqësit e megliseve të qytetit. *Mydyrrët* vendosnin sipas parimeve të shariatit. Në *mejlise* nuk kishte anëtarë të besimit katolik, thotë konsulli, ndërsa ortodoksët (serbët) përfaqësoheshin në meglise me nga dy ose tre anëtarë, andaj megliset kishin 9 ose 10 myslimanë. Gjyqet e vërteta tregtare nuk ekzistonin. Ekzistonte njëfarë komisioni nga anëtarët e megljisit, ku katolikët nuk ishin të përfaqësuar. Nuk ekzistonin gjyqet për kundravajtje. Fajtorët dënohen dhe dërgohen në burg. Nuk ekzistojnë vendime për dënime ose lirime nga burgu. Lirimi nga burgu bëhet me ryshfet dhe lidhje. Sistemi i burgimit është shumë i rëndë. Si burje përdoren fortesat që janë gjithmonë të plota.

Në sistemin tatimor Reformat e Tanzimatit nuk bënë ndryshime të mëdha. Banorët paguanin të dhjetën, doganën, tatimin për trashëgim, tatimin për ndërrimin e pronësisë, tatim për vend, për shtazë e të tjera. Te myslimanët u vu shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Mirëpo, kjo shumë vështirë realizohet te malësorët, ndërsa në rrafshina ndihet pakënaqësi e madhe e popullsisë. Shqiptarët myslimanë shpeshherë dezertojnë nga ushtria. Te krishterët paguajnë taksën për lirimin nga detyrimi ushtarak që quhet *nizamije* ose *bedelije* në vend të haraçit të dikurshëm që është tatim shumë i madh. Të krishterët paguanin edhe tatimet e tjera për hyrjen në qytet. Për qerre me katër rrotë paguanin një pjestër, ndërsa për qerre me dy rrotë 15 para. Tatimi i të dhjetës i shkatërronte fshatarët. »Kam parë në gjysmën e shtatorit plotë ara me duaj të grunit si i shkatërronte shiu dhe kalbeshin, sepse ndërmarrësit — tagrambledhësit ende nuk e kishin caktuar të dhjetën« — shkruan konsulli. Funksionarët shtetërorë — *mydyrët, kajmekamët* e të tjerë për plotësimin e nevojave të veta në të holla shpeshherë plaçkisnin popullsinë. Pushteti nuk siguronte nënshtetasit nga presioni dhe plaçka. Në lidhje me forcën ushtarake mbrojtëse të shtetit konsulli vë në dukje rrugët e pakalueshme, fortesat e qytetit të shkatërruara, në muret e tyre të shkatërruara qëndrojnë grykat e topave të ndryshëm, pa llafajete, pranë të cilave gjindeshin topxhinjtë, shumica të sëmurë. Funksionarët turq janë indolentë të painteresuar për gjendjen në vend ku sundojnë, ndërsa funksionet e pushtetit paguheshin shumë. Kajmekami i Shkupit merrte afër 36000 pjastra ose 2880 guldena rrogë vjetore.

Në fund të kësaj kaptine konsulli sjell si përfundim se pashallarët trashëgues para reformave ishin barbarë, sundues absolutë dhe tiranë, mirëpo, kishin fuqi dhe rreth vetes krijuan një jetë

të tërë, ndërsa administrata e tashme, që do të thotë pas reformave, është e mjerë, organet e saj janë të paafta. »Kjo administratë koheton me civilizimin, ndërsa vetë është e pacivilizuar ose fle në gjumë të thellë. Toka kalbet e njerëzit shkatërrohen«, — shkruan konsulli.

Në kaptinën e pestë *Disponimi i popullit, qëndrimi politik i popullit ndaj pushtetit osman*, konsulli shkruan për situatën politike në pashallëk. »Me siguri mund të vërtetoj — thotë konsulli — se malësorët e besimit islam dhe katolikë janë të pavarur, nuk mërzhiten për pushtetin dhe nuk paguajnë kurrfarë tatimesh. Ata vetëqeverisin në bazë të ligjeve të tyre të vjetra. Porta përpiqet t'i nënshtroj për të mbledhur tatime dhe ushtarë, por nuk ia arrin qëllimit. Në qytet ekziston një fraksion i pronarëve myslimanë të pakënaqur, të cilët rregullimin e ri e urrejnë, sepse prek interesat e tyre. Kjo shtresë i kundërvihet këtij rregullimi, herë haptazi, herë fshehurazi. Këta njerëz, të cilët mund të quhen patriotë shqiptarë, urrejnë çdo gjë të huajen, urrejnë pushtetin. Bujqit dhe zejtarët e rrafshinave dhe në qytet janë më të qetë, janë të kënaqur me fatin e tyre. Fshatarët vuajnë nga mundimet dhe tatimet e mëdha. Në këto shtresa shoqërore pushteti nuk gjen përkrahje, të gjithë të krishterët pa dallim feje, katolikë dhe ortodoksë, ndaj pushtetit osman janë armiqësisht të disponuar, mirëpo paraqesin rrezik të vogël për pushtetin osman. Katolikët janë në numër të vogël, ndërsa ortodoksët në fshatra dhe qytete nuk janë të armatosur dhe jo të përgatitur për luftë.

Në qytete popullsia me interesim ndjek ngjarjet politike, të cilat tundin themelet e Perandorisë Osmane. Nga Beogradi dhe Serbia bëhet ndikim i hapët dhe i dëmshëm, më tepër nderohet cari rus sesa autoriteti i sulltanit — shkruan konsulli asutriak. Konsulli në fund të kësaj kaptine thotë se propaganda pansllave në Pashallëkun e Prizrenit tash për tash nuk ka terren të përshtatshëm për veprimtarinë e vet ndërmjet popullsisë ortodokse.

Në kaptinën e gjashtë, *Përfaqësitë e jashtme në Pashallëkun e Prizrenit*, nevoja për vendosjen e agjentëve austriakë», konsulli, në bazë të situatës politike të veprimtarisë së diplomacisë dhe propagandës së shteteve të tjera në pashallëk, në këtë rajon e shih të nevojshme vendosjen e përfaqësive diplomatike austriake, të cilat duhet t'i kundërvihen propagandës së jashtme për realizimin e qëllimeve të Perandorisë Austriake në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik.

Në këtë raport konsulli e lajmëron qeverinë e vet për përfaqësitë diplomatike të shteteve të tjera dhe veprimtarinë e tyre. Sipas tij, konsullata e Francës në Prizren është hapur në vitin 1855, kur vicekonsulli Hecçuard me berat të sulltanit u pranua konsull në Prizren. Kjo konsullatë u vendos në lokalet e çaktuara me flamurin francez. Britania e Madhe në vitin 1857 themeloi një vicekonsullatë formale për Pashallëkun e Prizrenit ku si vicekonsull u emërua Blunti, i cili ishte nën konsullatën e Manastirit. Konsullata austriake në Shkup, në kuadrin e së cilit hynte edhe Pashallëku i Prizrenit, prej vitit 1851, sipas Majorit, nuk luante kurrfarë roli. Në vitin 1857 Ministria e Lartë e Punëve të jashtme dhe

e tregtisë e Austrisë u deklarua për themelimin e agjencisë konsullare për shkaqe religjioze, politike dhe ekonomike tregtare. Majori thekson se konsullata austriake do të fitonte besimin e qytetarëve të besimit katolik të Prizrenit. Sipas Majorit, personaliteti më i përshkrahshëm për konsull austriak në Prizren do të ishte zotëri Ignjac Petelenci, i cili i njëj gjuhët: turqishten, serbishten dhe shqipen dhe si mjek do të ketë gjithmonë influencë në popull.

Majori në fund të raportit flet për Shkupin. Ai thekson se afër Prizrenit është qyteti i përmendur Shkupi, vend me rëndësi tregtar — »pika e dytë qendrore e pashallëkut«. Shkupi nuk është lidhur direkt me komunikacion tregtar me Austrinë, por mban vetëm disa lidhje indirekte të vogla me tregtinë e Austrisë përtej Bosnjës dhe krahinave të Danubit, si dhe me Selanikun. Për afërsimin e këtij qyteti me tregtinë e Austrisë dhe për shkak të konkurrencës angleze, hapja e një agjencie konsullare do të ishte e nevojshme në këtë qytet. Konsulli e lajmëron qeverinë e vet për veprimtarinë propaganduese të vicekonsullit anglez si dhe për përgatitjen e Rusisë cariste për hapjen e përfaqësive diplomatike në këtë rajon. Kështu, majori kërkon nga qeveria austriake që të hapet një konsullatë edhe në Shkup, e cila do të t'i kundërvihej politikës angleze e ruse në këtë rajon, si dhe konkurrencës ekonomike.

Nga brendia e këtij raporti shihet qartë misioni i Majorit në rajonin e Sanxhakut të Prizrenit. Me këtë mision ai pati për qëllim të hulumtonte situatën politike dhe ekonomike në këtë rajon si dhe mundësinë e depërtimit të propagandës politike dhe ekonomike të Perandorisë Austriake në këto vende. Majorit i ka interesuar disponimi i popullsisë të këtij vendi ndaj pushtetit osman, si dhe disponimi i popullsisë së krishterë, posaçërisht asaj katolike, ndaj Austrisë. Ai në esencë ka përgatitur terrenin për veprimtarinë politike dhe diplomatike të Perandorisë Austriake në rajonin e Kosovës dhe më tej në Gadishullin Ballkanik.

*Dr. Emin Pllana*

LE RAPPORT DE MAJOR, CONSUL AUTRICHIEN A SCUTARI, EN 1858,  
SUR LE PACHALLIK DE PRIZREN (L'ORIGINAL DE CE RAPPORT  
SE TROUVE DANS LES ARCHIVES D'ETAT A VIEN)

R é s u m é

Le consul autrichien, Major — dans son rapport de 39 pages offre quelques données sur quelques régions du Pachallik de Prizren déjà mentionnées.

Le Gouvernement autrichien, à cette époque-là, montre des intérêts sur les régions d l'Empire ottoman en Balkans, surtout met l'accent sur le territoire du sandak de Prizren.

Le consul Major a visité des villes: Prishtinë, Skoplië, Tetovë, Prizren et d'autres. Dans ce rapport, il nous offre des données sur la population, l'économie, les circonstances culturelles et éducatives et l'administration et les représentants diplomatiques étrangers dans cette région.

Le but principal de sa visite n'était que l'étude des circonstances socio-politiques et la disposition de la population surtout celle chrétienne envers l'Empire ottoman. Il a bien étudié l'influence dans la région, de la propagande surtout anglaise, française, russe et serbe. Il a demandé l'ouverture d'une représentation diplomatique, surtout à Prizren ou à Skoplië pour renforcer la propagande autrichienne dans la région.

Le consul autrichien, Major a représenté l'administration turque incapable à maintenir l'ordre et la paix dans ces régions. Dans ce rapport, il montre la situation difficile de la population chrétienne surtout celle catholique dont l'Autriche était très intéressée. Il montre bien les circonstances économiques, culturelles et éducatives et aussi les rapports entre la population musulmane, orthodoxe et catholique ainsi que la résistance de la population contre le Gouvernement ottoman.